

**Emër Mbiemër**: Anesti Kondili
**Datëlindje**: 30.01.1943
**Vendlindje**: Korçë, Shqipëri
**Viti i zgjedhjes**: 2008 (akademik i asociuar), 2017 (akademik)
**Seksioni**: Shkencat natyrore dhe teknike
**Gjuhët:** frëngjisht, italisht, anglisht
**Kontakt:**

Adresa: Rruga "Faik Konica", Nd. 6, H. 5, Ap. 18, Tiranë
Telefon: +35542227318; +35542468568; Cel.: +355682124900
E-mail: anesti.kondili@akad.gov.al
ankondili@gmail.com
Faqe zyrtare: www.akad.gov.al

**CV e shkurtër**

Diplomuar në mjekësi në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Tiranës (1965).

Pedagog i Fakultetit të Mjekësisë qysh nga viti 1965 e në vazhdim, në katedrën e propedeutikës, e më pas në atë të kardiologjisë.

Specializim njëvjeçar në fushën e kardiologjisë dhe të hemodinamikës (1970–1971).

Specialist në Kardiologji (1972).

Specializim për reanimacionin kardiovaskular në Paris (tetor 1973 – maj 1974).

Organizues dhe drejtues i Njësisë (Shërbimit) Koronar Intensiv të departamentit të kardiologjisë nga viti 1976 pranë Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", ku vuri në përdorim për herë të parë në vendin tonë metoda të reja diagnostikimi dhe mjekimi, si: goditja elektrike e jashtme e zemrës, stimulimi elektrosistolik i përkohshëm dhe definitiv i zemrës, mjekimi farmakologjik dhe me elektrostimulim i aritmive, përdorimi i nitroglicerinës intravenoze etj.

Kandidat i shkencave mjekësore (1981) me disertacionin "Çrregullimet e ritmit dhe mjekimi i tyre në fazën akute të infarktit të miokardit"; docent në Fakultetin e Mjekësisë (1984); doktor i shkencave mjekësore (1988) me disertacionin "Takikarditë paroksizmale"; profesor në Fakultetin e Mjekësisë (1991).

*American Heart Association Council Member* (1996, 1997); anëtar i *European Society of Cardiology* (1996–); anëtar i Akademisë Mjekësore të Polonisë (1998); anëtar i Akademisë Botërore të Mjekësisë "Albert Schweitzer" (1999); dekan i Fakultetit të Mjekësisë (1997–2000); koordinator i projektit klinik ALBA S-JEP-11004-96 në kuadrin e programit "Tempus" (1997–1999); Fellow of European Society of Cardiology (2000– ); anëtar organizues i Komitetit të "Euro-Asian Bridge" (2004–); akademik i asociuar, zgjedhur në Asamblenë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (zgjedhur më 2008); anëtar i Kempit Epror të Kardiologjisë (nga viti 1984) dhe kryetar i tij (1989–2005) e përsëri anëtar (2006–2008); zëvendëspresident i Shoqatës Shqiptare të Kardiologjisë nga (2007–2010); president i Shoqatës Shqiptare të Kardiologjisë (2001–2004); anëtar i Komisionit Kombëtar të Gjykimit Ndërdisiplinor Profesional, pranë Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë; zëvendëspresident i Shoqatës së Kardiologjisë Invazive Shqiptare (2007–); ekspert për fushën e mjekësisë pranë Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (2010); kryetar e më pas anëtar i redaksisë së mjekësisë dhe të farmaceutikës për

ribotimin e "Fjalorit enciklopedik shqiptar" (2008); anëtar i redaksisë së "Buletinit të shkencave mjekësore" (1980–1991 dhe 1998–2012); anëtar i redaksisë së "Revistës kardiologjike shqiptare" dhe kryeredaktor i saj nga viti 2008–2011; anëtar i redaksisë së revistës "OPTIME" e *Albanian University* dhe nga dhjetori 2013 kryeredaktor; zëvendësrektor i *Albanian University* (2011–).

**Vlerësime**

Urdhri "Naim Frashëri", kL. II. (1979) ; Urdhri i Punës, i kl. I (1989); "ALBERT SCHWEITZER GOLDEN MEDAL" (1998); urdhri "Mjeshtër i Madh" akorduar nga Presidenti i Republikës, Bamir Topi (2012); certifikatë mirënjohjeje me rastin e 60-vjetorit të themelimit të Fakultetit të Mjekësisë (2012); certifikatë mirënjohjeje në kuadër të 100-vjetorit të Pavarësisë nga Ministria e Shëndetësisë.

**PUBLIKIME**

**Autor, bashkautor, redaktor e bashkëredaktor i 15 teksteve mësimore** për studentët e mjekësisë dhe për shkollat e mesme mjekësore; "Elektrokardiografia"(për studentët e Fakultetit të Mjekësisë) – 1970; "Elektrokardiografia dhe fonokardiografia" (për studentët e Fakultetit të Mjekësisë) – 1972; "Sëmundjet e brendshme" (për shkollat e mesme mjekësore) – 1970 dhe 1973; "Sëmundjet e brendshme" (për shkollën e mesme mjekësore, profili dentist, farmacist) – 1972. "Diagnostika e sëmundjeve të brendshme" – 1975; "Sëmundjet e brendshme" (për shkollat e mesme, mami, infermier), pjesa e parë 1980; "Njohuri mbi sëmundjet" (për studentët e degës farmaci) – 1983; "Sëmundjet e brendshme" (për shkollat e mesme) – 1986; "Leksione të kardiologjisë" (për studentët e Fakultetit të Mjekësisë) – 1986, 1988; "Kardiologjia" (për studentët e Fakultetit të Mjekësisë) – 1991; përkthim dhe përshtatje e librit: "Reanimacioni në patologjinë kardiovaskulare" – 1996; "Semiologjia klinike" – 1998;" "Curriculum form Medical Graduate" (Prepared according to Med-Alba and Clinic Alba Tempus Projects) – 1999; "Medical Education in Albania" në "Medical Education in Europe" – 1999 (f. 11, 14-16). "Sëmundjet e zemrës" – 2001.

**Autor dhe bashkautor** i **83 artikujve** të botuar në revistat mjekësore të vendit, **12 artikujve të botuar** në revista të huaja mjekësore, **pjesëmarrës dhe referues** në 51 kongrese, konferenca e simpoziume shkencore ndërkombëtare, **referues** në **105 simpoziume dhe konferenca** kombëtare, **recensent dhe oponent** i 40 disertacioneve**,** monografive dhe punimeve për grada të ndryshme shkencore etj., **udhëheqës i 3 diplomave** të studentëve të mjekësisë, i **4 tezave** të shkollës pasuniversitare dhe i **5 disertacioneve** për shkallën e parë të mjekëve kardiologë.

**Monografi:**

1. Kondili, Anesti. *Çrregullimet e ritmit dhe mjekimi i tyre në fazën akute të infarktit të miokardit*. Botim i UT, Tiranë, 1982. 167 f. (+ atlas me elektrokardiograma të 28 pacientëve nga materiali i studiuar – 33 f.)
2. Popa, Ylli; Çina, Pandeli; Kondili, Anesti. **"**Kritere për përcaktimin e aftësisë në punë për të sëmurët me sëmundje Ishemike të zemrës". Në librin *Kritere orientuese për përcaktimin e aftësisë në punë*. Botim i Ministrisë së Financave, Tiranë, 1980.
3. Kondili, Anesti; Beqari, Neki. *Antikoaguluesit, antiagreguesit, trombolitikët*. Botim i

Drejtorisë së arsimit shëndetësor, Tiranë, 1985, 217 f.
4. Kondili, Anesti. *Takikarditë Paroksizmale.* Shblu, Tiranë, 1990, 248 f.
5. Kondili, Anesti. *Elektrokardiografia Klinike.* Toena, 2011, 323 f.

**Lista e plotë e punimeve shkencore gjendet në dosjen e akademikut pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë**